Ambasadori Wohlers nënshkruan marrëveshje për Fulbright

6 tetor 2011

Më 6 tetor, ambasadori Wohlers dhe ministri për arsim Kralev nënshkruan një marrëveshje mes SHBA-ve dhe Maqedonisë për programin për shkëmbim të studentëve Fulbright.

Marrëveshja formalizon mundësi më të mëdha për studentët dhe ekspertët e të dy vendeve që të ndajnë ide, të kuptojnë më mirë popujt dhe të kontribuojnë më tepër për komunitetet e tyre pas kthimit në shtëpi.

Gjatë viteve, në këtë program të dalluar kanë marr pjesë mbi 230 qytetarë nga Maqedonia. Këtë vit, në Fulbright programin do të marrin pjesë gjashtëmbëdhjetë persona: njëmbëdhjetë nga Maqedonia do të studiojnë e do të bëjnë hulumtim në Shtetet e Bashkuara, dhe pesë të tjerë kanë ardhur nga Amerika për të bërë hulumtime, për të studiuar dhe për të mësuar të tjerët.



Str. "Samoilova" Nr.21 1000 Skopje /Telephone (+389) (2) 310 2000, Fax (+389) (2) 310 2499 E-mail: EmbSkoWebM@mt.net.mk